

POLITIKA E PRIVATËSISË

Kjo Politikë Privatësie shpjegon mënyrën se si Atlantik – Shoqëri Sigurimesh sh.a mbledh, përdor, ruan dhe mbron të dhënat personale të përdoruesve që vizitojnë ose përdorin shërbimet e ofruara në faqen zyrtare të internetit.

1. Kontrolluesi i të dhënave personale

- Kontrolluesi i të dhënave personale është Atlantik – Shoqëri Sigurimesh sh.a, NUIS K11807008V, me seli në Rruga “Themistokli Gërmenji”, nr. 3/1, Tiranë, Shqipëri.
- Për çdo pyetje në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale, mund të kontaktoni Nëpunësin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DPO) pranë kompanisë, në adresën e-mail: margen.madhi@atlantik.com.al.

2. Kuadri ligjor

- Përpunimi i të dhënave personale kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi Nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Ligjit Nr.32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Rregullore nr.125/2021 “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, si dhe veçanërisht Ligjin nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve nënligjore në fuqi.

3. Çfarë të dhënash personale mbledhim

Atlantik – Shoqëri Sigurimesh sh.a mund të mbledhë dhe përpunojë këto kategori të dhënash personale:

- **Të dhëna personale:**
Përfshijnë emrin dhe mbiemrin, datëlindjen, atësinë, numrin e telefonit, e-mailin, targën e mjetit, numrin e kartës ID ose numrin e identifikimit të pasaportës, gjinia, adresa. Këto të dhëna përdoren për regjistrimin në sistemin online dhe/ose kryerjen e procedurës për leshimin e polices se kërkuar apo kërkesës për dëmshpërblim sipas kategorive të përcaktuara.
- **Të dhënat motorrike identifikuese:**
Përfshijnë targën e mjetit dhe numrin e shasisë.
- **Të dhëna për shëndetin (Të dhëna sensitive) dhe penale.** Në raste të caktuara, gjatë trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, kompania mund të përpunojë kategori të veçanta të të dhënave personale si të dhëna shëndetësore dhe/ose penale. Ky përpunim kryhet vetëm kur është i domosdoshëm për përmbushjen e detyrimeve ligjore në rastet e dëmshpërblimit dhe në përputhje me nenin 9 të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

- Cilët janë subjektet të cilëve ju përpunohen të dhënat:

Klientët e kompanisë, përfituesit e policave, palët e dëmtuara, vizitorët e faqes së internetit, partnerët kontraktualë.

4. Qëllimi i përpunimit të të dhënave

Të dhënat personale përpunohen për këto qëllime:

- Lëshimin dhe administrimin e policave të sigurimit.
- Trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim
- Përmbytjen e detyrimeve ligjore dhe rregullatore, përpunim i cili kryhet në përputhje me qëllimin, që nënkupton se të dhënat personale mbledhen për një qëllim specifik e të ligjshëm dhe nuk përpunohen më tej për një qëllim tjetër, që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar.
- Administrimin e marrëdhënieve kontraktore me klientët
- Përmirësimin e shërbimeve dhe produkteve të ofruara

5. Për punimi i të dhënave

Përpunimi i të dhënave personale bazohet në :

- Përmbytje të një detyrimi ligjor, në referim dhe të nenit 7 pika 1/c. Ligji nr .124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Ekzekutimi i një kontrate. Ligji nr 52 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
- Pëlqimi i dhënë nga subjekti i të dhënave kur kërkohet nga ligji (Deklarata e pëlqimit) për përpunimin e të dhënave, në referim të nenit 7 pika 1/a. Ligji nr .124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

6. Transferimi i të dhënave tek palët e treta

- Të dhënat personale mund t’u komunikohen institucioneve ose palëve të treta vetëm kur kjo është e nevojshme për përmbytjen e detyrimeve ligjore ose për realizimin e shërbimeve të sigurimit. Këto mund të përfshijnë autoritete rregullatore si AMF (Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare), institucione publike ligjzbatuese si (Prokurori, gjykata, polici), partnerë kontraktualë si dhe/ose institucione shëndetësore, sipas rasteve. Në rast se të dhënat personale transferohen jashtë Republikës së Shqipërisë, Atlantik- Shoqeri Sigurimesh sha, siguron që transferimi të kryhet vetëm në përputhje me mekanizmat ligjorë të parashikuar nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale

7. Ruajtja e të dhënave personale

- Të dhënat personale ruhen vetëm për periudhën e nevojshme për përmbytjen e qëllimeve për të cilat janë mbledhur dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga politikat e brendshme të kompanisë. Ne i trajtojmë të dhënat personale dhe i ruajmë ato në serverat e menaxhuar nga stafi i autorizuar i

ATLANTIK - SHOQERI SIGURIMESH SHA

kompanisë. Këto servera janë të vendosur në zyrat qendrore dhe sigurojnë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje, siç kërkohet nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Të dhënat personale me dokumentacion fizik, gjatë procesit të përpunimit ruhen për një kohë të caktuar, deri në përfundim të qëllimit për të cilin janë mbledhur dhe pas këtij afati, ato arkivohen dhe ruhen për një periudhë sipas afateve të përcaktuara në rregulloren për “Menaxhimin, ruajtjen, arkivimin dhe asgjësimin e dokumentave” të Kompanisë dhe pas kalimit të këtij afati ato asgjësohen. Asgjësimi kryhet nëpërmjet një urdhëri ku janë të përcaktuar personat përgjegjës për asgjësimin e dosjeve jashtë afatit, duke garantuar që asnjë informacion i ndjeshëm të mos ruhet jashtë kohës së lejuar.
- Ne i ruajmë të dhënat tuaja personale sipas një kategorizimi të caktuar si më poshtë:
- Kontratat e sigurimit, policat e sigurimit dhe certifikatat e sigurimit 4 deri 7 vjet.
- Praktikat e dëshmipërblimeve 5 deri 15 vjet.

8. Siguria e të dhënave

- Atlantik – Shoqëri Sigurimesh sh.a ka marrë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale nga humbja, përdorimi i paautorizuar, ndryshimi ose zbulimi i paautorizuar, nëpërmjet krijimit të rregulloreve specifike dhe zbatimin e tyre rigoroz nga stafi i cili përpunon këto të dhëna. Atlantik- Shoqeri Sigurimesh sha, aplikon masa teknike dhe organizative si kontrolli i aksesit, autentifikimi i përdoruesve, enkriptimi i të dhënave dhe monitorimi i sistemeve për të parandaluar aksesin e paautorizuar.
- Në rast të cënimit të të dhënave personale Atlantik Sha nëpërmjet (DPO) Nëpunësit të të dhënave personale, si personi i kontaktit me Komisioni, njofton këtë të fundit sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë pas marrjes dijeni për cënimin. Ky njoftim nuk kryhet kur nuk janë kushtet e kryerjes së një cënimi të lartë të këtyre të dhënave.

9. Të drejtat e subjektit të të dhënave

Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e mëposhtme në përputhje me Ligjin nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”:

- E drejta për informim
- E drejta e aksesit në të dhënat personale
- E drejta për korrigjim ose përditësim të të dhënave
- E drejta për fshirje në rastet e parashikuara nga ligji
- E drejta për kufizimin e përpunimit
- E drejta për të kundërshtuar përpunimin
- E drejta për transferueshmërinë e të dhënave
- E drejta për të paraqitur ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

ATLANTIK - SHOQERI SIGURIMESH SHA

Për të ushtruar ndonjëherë nga të drejtat e mësipërme, ju lutemi dërgoni një e-mail në adresën: margen.madhi@atlantik.com.al ose një kërkesë me shkrim në adresën: Rruga “Themistokli Gërmenji” 3/1, Atlantik sha, Tiranë, Shqipëri.

Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar identitetin e kërkuarit. Atlantik sha, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit. Kur Atlantik sha ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e personit, i cili paraqet kërkesë, kontrolluesi kërkon informacion shtesë, me qëllim verifikimin e identitetit të subjektit të të dhënave.

Kërkesa për informacion

Kërkesën për informacion mund ta bëj:

- Vetë personi ;
- Përfaqësuesi ligjor i pajisur me autorizimin përkatës;
- Prindi ose kujdestari kur :
- Fëmija nuk ka zotësi të plotë për të vepruar
- Prindi është duke vepruar në interes të fëmijës.
- Personat të cilët megjithëse nuk kanë një interes të drejtpërdrejtë, provojnë se kanë një interes të ligjshëm për të marrë dijeni në lidhje me dokumenta të caktuar.
- Organe shtetërore dhe institucione publike, në përputhje me ligjin, për kryerjen e detyrave të tyre ligjore;

10.Vendimet automatike

Atlantik sh.a nuk përdor vendimmarrje automatike ose profilizim që prodhon efekte ligjore mbi subjektet e të dhënave

11. Cookies

Faqja e internetit mund të përdorë cookies për të përmirësuar përvojën e përdoruesve dhe për të mbledhur informacione statistikore mbi përdorimin e faqes. Përdoruesit mund të konfigurojnë shfletuesin e tyre për të refuzuar cookies.

12. Ndryshimet në politikën e privatësisë

Atlantik – Shoqëri Sigurimesh sh.a mund të përditësojë këtë politikë herë pas here. Çdo ndryshim do të publikohet në faqen zyrtare të internetit.

13. Kontakt

Për çdo pyetje ose kërkesë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe/ose në lidhje me këtë Politikë Privatësie mund të kontaktoni në adresën e-mail: margen.madhi@atlantik.com.al. dhe/ose në numrin e kontaktit 00355/42230506

Përditësuar datë 10/03/2026